- NJ. A. Pirg
- ST IMP
dt 27.01.2025

BAS...A M
Z... e Prof
Nr. 338 ... Prot. .....
Date 27.01.2025 Nenshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLES SE PARE E JURIDISKIONIT TE PERGJITHSHEM KORÇË

Nr. Akti 175/230/258/563/1466 **Korce, sot më datë 20.01.2025**

NJOFTIM ME SHPALLJE
"I kunderpadise te pales te paditur Andrea Sholla dhe kerkeses per leshimin e "Deklarates te mbrojtjes"

Drejtuar Njesise Administrative Pirg, Bashkia Maliq
Për palen e paditur ne k/padi: ***Shoqeria Ndertimi 1/1 sh.p.k. me seli ne Korce, Pirg, Zvirinë, Magazinë pranë Shkollës 9 vjeçare te fshatit Zvirinë, Njesia Administrative Pirg.***
LËNDA: Njoftimin e kërkesëpadisë dhe akteve provuese, si dhe ne lidhje me deklaratën e mbrojtjes.

Përpara Gjykatës së Shkalles se Pare e Juridisionit te Pergjithshem Korçë është regjistruar çështja civile me te dhenat si më poshtë vijon:
Padites : ***Kamela Plasa*** *e bija e Pirro, e dtl.1995, lindur dhe banues ne Korçë, perfaqesuar nepermjet prokures te posacme me nr.3083 rep. e nr.2786 kol. e dt.17.06.2017 nga e ëma, Luiza Plasa.*
I paditur : Andrea Sholla, *i biri i Dhimitraq, i dtl.1974, lindur dhe banues ne Korce me adrese : "Blloku i Ri i Sportit", pall.12, Shk.1, Kati I, Apartamenti 3, perfaqesuar nepermjet prokures me nr.7361 rep. e nr.5156 kol. e dt.12.11.2019 nga av. Arben Shushi.*
Objekti *: Lirim dhe dorezim i pasurise se paluajtshme të llojit apartament, te ndodhur ne ZK 8561, pasuri me nr. 1/393+2-7, me siperfaqe 94.01 m2.*
Detyrimin e pales se paditur te paguaje vleren e perdorimit te baneses, per periudhen 2016-2021, dhe deri ne momentin e dorezimit te sendit.
Baza ligjore : *neni 32/a, 200/d i K.Pr.Civile, neni 298, neni 296 te K.Civil.*

Pas depozitimit ne gjykate ne dt.01.06.2023 te kerkeses ne kuader te kunderpadise nga i padituri **Andrea Sholla** me pale ndergjyqese :
I paditur kundepadites : Andrea Sholla, , *i biri i Dhimitraq, i dtl.1974, lindur dhe banues ne Korce me adrese : "Blloku i Ri i Sportit", pallati I Piro Plasa, mbrojtur ne gjykim me deklarim ne séance nga av. Arben Shushi*
Paditese e kunderpaditur : Kamela Plasa *e bija e Pirro, e dtl.1995, lindur dhe banues ne Korçë, perfaqesuar me prokure te posacme nga e ëma, Luiza Plasa.*
Te paditur ne kunderpadi : 1. Shoqeria Ndertimi 1/1 sh.p.k. *me seli ne Korce, L.12, Rr."Kristo Grabocka", nr.21.*
2. Luiza Plasa *e bija e Mehmet, e dtl.1961, banuese ne Korce, Lagjia .11, Rr."Llazo Pulluqi " nr.10.*
3. Elena Plasa *e bija e Piro dhe Luiza, e dtl.1991, banuese ne Korce, Lagjia .11, Rr."Llazo Pulluqi " nr.10.*
4.Piro Plasa *i biri i Sotir, i dtl.1957, banuese ne Korce, Lagjia .11, Rr."Llazo Pulluqi " nr.10.*
5. Agjensia Shteterore e Kadastres, Zyra Vendore Korçë
Objekti : *Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates te shitblerjes dt.31.01.2007 midis shoqerise se Ndertimit 1/1 dhe Luiza Plasa.*

Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates te shitblerjes nr.2988 rep. e nr.2664 kol. dt.30.09.2011 te Noterise Korce.
Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates te shitblerjes nr.282 rep. e nr.259 kol. dt.04.02.2014 te Noterise Korce.
Konstatimin e pavlefshmerise deklarates te heqjes dore nga pronesia nr.4309 rep. e nr.4000 kol.
Detyrimin e te paditurve te njohin pronat te paditurin kunderpadites Andrea Sholla ne pasuria me nr.1/393+2-7 ndodhur ne ZK.8561, vol.34, fq.183 me adrese ne Blloku i Ri i Sportit, e llojit apartament me siperfaqe 94,01 m2.
Ç'regjistrimin e regjistrat e ZVRPP te deklarates te heqjes dore nga pronesia nr.4309 rep. e nr.4000 kol. dt.30.08.2017 te Noterise Korce.
***Baza ligjore** : neni 31, 32/a, 55, 160 te K.Pr.Civile, neni 92/a, ç dhe 296, 705 e vijues te K.Civil.*

Gjykata pas studimit paraprak formal të çështjes, konstatoi se kundërpadia paraqitet pa të meta dhe e plotë, prandaj bazuar në nenin 158/1 të K.Pr.Civile, vlerësoi t'iu njoftojë një kopje të saj dhe provat bashkëlidhur. Gjatë veprimeve paraprake gjykata rezulton qe pala e paditur ne kunderpadi te mos gjendet ne adresen e saj. Nisur nga ky fakt, gjykata vendosi të përsëritë njoftimin e kunderpadisë dhe një kopje të akteve provuese të padituri Shoqeria Ndertimi 1/1 sh.p.k.

Njoftimi do të bëhet me shpallje konform nenit 133/b, pka 1, të K.Pr.Civile. ***Kërkojmë që brenda 30 ditëve nga momenti i njoftimit të tyre,të paraqisni "Deklaratën e mbrojtjes" pranë K/sekretarisë së Gjykatës së Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Korçë (drejtuar Gjyqtares Eglantina Mikani).***

Deklarata e mbrojtjes hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:
emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin Tuaj dhe të personit/ave që i'u përfaqëson/jnë, nëse keni të tillë;
tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse keni;
Përveç këtyre kërkesave, duhet të deklaroni qartë në/ose bashkëngjitur deklaratës së mbrojtjes:
të dhënat e kontaktit Tuaj elektronik, ose të përfaqësuesit/ve Tuaj, nëse keni, të cilat gjykata mund t'i përdorë për t'iu njoftuar. Në vijim të procesit keni detyrimin të informoni gjykatën për çdo ndryshim të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik Tuajat, apo të përfaqësuesi/vet. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit;
listën e personave që kërkoni të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit (nëse kërkoni thirrjen e dëshmitarëve), duke specifikuar saktë emrat e tyre, atësinë, mbiemrin dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
provat që kërkohen të merren tek të tretët ose te paditësi, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave (nëse ka të tilla);
llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit (nëse kërkoni kryerjen e ndonjë ekspertimi);
emrin, atësinë, mbiemrin, ose emërtimin e personit juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi (nëse kërkoni thirrjen e ndonjë personi të tretë);
kundërpadinë, kur kërkohet prej Jush ushtrimi i kësaj të drejte, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

Gjykata Ju bën me dije se për të hartuar "Deklaratën e mbrojtjes", apo realizuar një mbrojtje efektive në tëresi në kuadër të këtij procesi gjyqesor, mund të kërkoni ndihmë ligjore të kualifikuar prej nje avokati/juristi.

Gjykata Ju bën me dije se mosparaqitja e "Deklaratës së mbrojtjes" dhe provave brenda 30 diteve nga momenti i njoftimit të padisë, sipas elementëve dhe kërkesave të sipër përmendura, sjell si pasojë mospranimin më vonë prej Gjykatës të prapësimeve dhe provave që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesën Tuaj!

Kujdes! Merrni të gjitha masat për paraqitjen e Deklaratës së mbrojtjes brenda 30 ditëve nga komunikimi i këtij njoftimi dhe akteve shoqëruese (kërkesëpadia dhe provat).

GJYQTARE
Eglantina MIKANI

Shënim: *Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.*
Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykate, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u afishua sot në datë_____.

Për Njesine Administrative _____